



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KESHILLI BASHKIAK

Proces-verbal

**A. Të dhëna të përgjithshme**

Për miratimin e “Kodit të Sjelljes”, Bashkia Elbasan

Data e takimit: 11.07.2025

Vendi i takimit: Salla Multifunktionale, Bashkia Elbasan

Ora e hapjes së takimit: 10:30

Kryesuesi i takimit: Z. Lutfi Lala, Kryetar i Keshillit Bashkiak Elbasan

Këshilltarë pjesëmarrës në takim, nr 3

emrat:

Eva Bica

Kejsi Çakani

Sokol Sinani

Anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Çështjet Ligjore

Nr 2

Punonjës të administratës pjesëmarrës në takim, nr 11

Emrat: Ervin Muço, Lorena Haxhiymeri, Edvin Palloshi, Aida Talelli, Ardiola Bajraktari,  
Ana Vrioni, Marsida Biba, Nadire Kreka, Elona Kaçi, Ana Vrioni, Enea Sanço

Anëtarë të strukturave komunitare pjesëmarrës në takimi, nr 4

Emrat: Komuniteti Rom dhe Egjiptian

Tjeter Vizion

Media Miranda Sadiku

Artiola Tashi

Pjesëmarrës në takim nga komuniteti: nr 18

Nga te cilet vajza/gra: nr 11

## **B. Zhvillimi i takimit.**

Prezantimi i draft Planit të Integritetit, Bashkia Elbasan

Prezantimi i pyetjeve, çështjeve për të cilat kërkohet opinion i publikut, Kryetari i Grupit dhe Këshilltari , Zj/Z Ervin Muço

Pyetje nga publiku:

1.Pyetje nga Organizata Tjeter Vizion

Pse ishte e nevojshme rishikimi dhe miratimi i një Kodi të ri Sjelljeje?

Përgjigje nga punonjësi i Bashkisë, Kryetari i grupit të Punës: Z. Ervin Muço

Rishikimi ishte i nevojshëm për ta përputhur Kodin me ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore të viteve të fundit, si dhe për të përfshirë rregulla më të detajuara për konfliktin e interesit, menaxhimin e dhuratave, komunikimin me publikun dhe mekanizmat e sinjalizimit, në përputhje me VKM nr. 873/2021 dhe udhëzimet e ILDKPKI.

2. Pyetje nga Mediat

Çfarë përfshin Kodi i ri i Sjelljes?

Për kë zbatohet Kodi?

Përgjigje e pyetjeve: Koordinatori Performancës, anëtar i Grupit të Punës: Lorena Haxhiymeri

Kodi përcakton standardet e etikës dhe sjelljes për punonjësit e Bashkisë, përfshirë: parimet bazë të integritetit, ndalimin e korrupsionit, parandalimin e konfliktit të 2nterest, rregullat për dhuratat, përdorimin e pasurisë publike, ruajtjen e informacionit, komunikimin me qytetarët, parandalimin e ngacmimit në vendin e punës dhe procedurat e sinjalizimit të parregullsisive.

Kodi zbatohet për të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe institucioneve vartëse, përfshirë të punësuarit me kontrata projekti, praktikantët dhe personat që përfaqësojnë Bashkinë në çdo formë, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre.

3. Pyetje nga Sekretari i Këshillit Bashkiak, Sokol Sinani

Si do të sigurohet zbatimi I Kodit në praktikë?

Përgjigje nga punonjësi i Bashkisë, Kryetari i grupit të Punës : Z. Ervin Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
KESHILLI BASHKIAK

Përveç publikimit në faqen zyrtare dhe shpërndarjes për çdo punonjës, Kodi do të shoqërohet me trajnime periodike dhe me detyrimin për të firmosur “Deklaratën e njohjes së Kodit”. Një raport vjetor mbi zbatimin do t’i paraqitet Këshillit Bashkiak.

4. Pyetje nga Mediat dhe Komisioni Keshillit Bashkiak

Çfarë ndodh nëse një punonjës shkel Kodin e Sjelljes?

Shkeljet trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil ose marrëdhëniet e punës, duke nisur nga vërejtja me shkrim deri te procedurat disiplinore dhe masat administrative ose ligjore përkatëse.

5. Pyetje nga anëtarët e Komisionit të Keshillit Bashkiak

Kush do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes?

Sa shpesh do të raportohen rezultatet e monitorimit?

Përgjigje nga punonjësi i Bashkisë, Kryetari i grupit të Punës : Z. Ervin Muço

Monitorimi do të kryhet nga **Drejtoria e Burimeve Njerëzore** në bashkëpunim me **koordinatorin e Performancës**, me raportim vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe publikim të përmbledhjes për qytetarët.

Raportimi do të bëhet **një herë në vit** pranë Këshillit Bashkiak dhe në mënyrë të përmbledhur do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë. Në raste të veçanta, raportim i jashtëzakonshëm mund të bëhet me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë ose të Këshillit.

**C. Konkluzionet e takimit Kryetari i Keshillit Bashkiak, Z Lutfi Lala dhe Kryetarit te Grupit të Punës Z.Ervin Muço.**

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Lutfi Lala, dhe Kryetari I grupit të Punës Z. Ervin Muço, falenderuan anëtarët e Këshillit Bashkiak, Anëtarët e Forumit OGP, Mediat dhe Grupin e Punës për diskutimet dhe vlerësimet e dhëna gjatë shqyrtimit të “Kodit të Sjelljes së Bashkisë Elbasan”.

U theksua se ky dokument përbën një bazë të rëndësishme për forcimin e kulturës së integritetit, etikës dhe profesionalizmit në administratën vendore, duke përcaktuar qartë

rregullat e sjelljes, parandalimin e konfliktit të interesit, menaxhimin e dhuratave dhe ruajtjen e komunikimit korrekt me qytetarët.

Z. Lala nënvizoi rëndësinë e monitorimit të zbatimit të Kodit dhe raportimit të rregullt pranë Këshillit Bashkiak, si dhe angazhimin e administratës për organizimin e trajnimeve periodike dhe garantimin e njohjes së detyrueshme të Kodit nga të gjithë punonjësit.

D. **Mbyllja e takimit.** Ora 12:15

Sekretari Keshillit Bashkiak

Sokol Sinani

